



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

## **PROCESVERBAL**

Tiranë, më 25 shtator 2018, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

### **Rendi i ditës:**

1. Projektvendim/Kërkesë “Për një shtesë personeli në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”
2. Projektvendim “Për disa ndryshime të strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit”
3. Projektvendim/Kërkesë “Për shtesë të numrit të punonjësve dhe riklasifikim të pagave të administratës së institucionit të Komisionerëve Publikë”
4. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt Am Main, për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV””
5. Seancë dëgjimore me kandidatët për një vend vakant në Bordin e Institutit për Studimet e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri.

### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina dhe Tom Doshi.

### **Mungojnë:**

Oerd Bylykbashi, Enkelejd Alibeaj, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka.

**Të ftuar :**

Genta Tafa - Kryetare e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Valbona Sanxhaktari – përfaqësuese nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit

Laerta Poda - Sekretare e Përgjithshme e Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Emli Beqiraj - Drejtore Finance pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Dariel Sina - komisioner publik

Florian Ballhysa - komisioner publik

Elton Haxhi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Vilma Causholli - shefe Sektorit të Politikave të Pagave në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Brikena Jazxhi - specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Enkela Dudushi - drejtoreshë e Sektorit të Organizimit, Funkcionimit dhe Zhvillimit të Pagave pranë DAP-it

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** – Përshëndetje të gjithëve!

Le të hyjë media!

Fillojmë mbledhjen e komisionit për ditën e sotme.

Kuorumi është i mjaftueshëm për të vazhduar me rendin e ditës. Sot kemi një rend dite shumë të ngjeshur, janë 5 çështje për diskutim.

Si pikë e parë është projektvendimi “Për një shtesë personeli në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”. Komisioni ynë është komision përgjegjës.

Si pikë e dytë është projektvendimi “Për disa ndryshime të strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”. Komisioni ynë është komision përgjegjës.

Si pikë e tretë në rendin e ditës kemi projektvendimin “Për shtesë të numrit të punonjësve dhe riklasifikim të pagave të administratës së institucionit të Komisionerëve Publikë”. Komisioni ynë është komision përgjegjës.

Si pikë e katërt është projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt Am Main, për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV”. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi.

Si pikë e fundit është seanca dëgjimore me kandidatët për një vend vakant në Bordin e Institutit për Studimet e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri. Komisioni ynë është komision përgjegjës.

Fillojmë diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës, projektvendimi “Për një shtesë personeli në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Relator i këtij projektvendimi është zoti Bashkim Fino.

Ka konfirmuar pjesëmarrjen zonja Genta Tafa, kryetare e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ju lutem, zonjë, zini vend!

Zoti Fino, dëshironi që të flisni për të tri projektvendimet?

Po ashtu edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit kanë konfirmuar pjesëmarrjen: zonja Laerta Poda, Sekretare e Përgjithshme e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Nga Komisionerët Publikë kanë konfirmuar pjesëmarrjen: zoti Florian Ballhysa, komisioner publik dhe zoti Dariel Sina, komisioner publik.

Ju lutem, zini vendet!

Meqenëse të trija projektvendimet janë për institucionet e vetingut dhe kanë të njëjtën përmbajtje në kërkesat që kanë bërë, vazhdojmë me projektvendimin e parë, “Për një shtesë personeli në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Zonja Tafa, ju lutem na bëni shkurtimish një prezantim të kërkesës suaj për kolegët e komisionit, por edhe për opinionin publik.

Para se ta marrë fjalën zonja, do të doja t’ju bëja me dije se kolegu im, relatori Bashkim Fino ka qenë në komunikim të vazhdueshëm dhe konsultë të përhershme me të tre drejtuesit e institucioneve të vetingut dhe besoj se mes tyre është gjetur mirëkuptimi dhe dakordësia për kërkesat, por gjithsesi këto kërkesa duhet t’u bëhen të ditura edhe kolegëve, por edhe opinionit publik.

Fjala për ju, zonja Tafa.

**Genta Tafa** – Përshëndetje!

Në fakt, ne kemi qenë në këtë sallë, bashkë me ju, para një viti kur miratuam strukturën e këtij institucioni dhe unë pata thënë se nuk jam në gjendje të parashikoj se cili do të jetë fluksi i punës dhe çfarë do të bëjmë ne për të parashikuar në mënyrë të saktë strukturën që kërkuam atëherë.

Pas pothuajse një viti punë, kuptuam që kemi sërish nevojë për shtesë stafi dhe i jemi drejtuar Kuvendit, si organi kompetent, për një shtesë në strukturën e institucionit tonë duke kërkuar 8 këshilltarë ekonomikë, në kushtet kur ne kemi vetëm 4 prej tyre, fluksi i dosjeve është i madh dhe këta konkurrojnë në fluks pune së bashku me 12 këshilltarët juridikë. Duke qenë se po hasim vështirësi dhe vonesa në trajtimin ekonomik dhe financiar të dosjeve të procesit të rivlerësimit, kemi parë të arsyeshme që të barazojmë numrin e këshilltarëve juridikë me numrin e këshilltarëve ekonomikë, në mënyrë që të punohet paralelisht me komisionerin.

Gjithashtu, kemi kërkuar shtesë personeli me dy përkthyes. Aktualisht kemi 3 përkthyes. Sipas Kushtetutës, gjuha zyrtare e punës së komisionit është gjuha shqipe dhe gjuha angleze. Është e kuptueshme që të gjithë në institucionin tonë, si stafi i rekrutuar nga ju dhe ai i rekrutuar nga ne si institucion më vete, e zotërojnë gjuhën angleze, por fluksi i madh i materialeve duhet të jetë i gjithi i përkthyer për shkak të marrëdhënies mbikëqyrëse dhe monitoruese të Operacionit

Ndërkombëtar të Monitorimit. Në këto kushte, me këtë shtesë që kemi kërkuar, shkojnë në total 5 përkthyes.

Nga ana tjetër, kemi kërkuar shtesë personeli, dy specialistë për protokoll-arkivën. Aktualisht ne kemi një specialist të tillë. Unë kam kërkuar këtë shtesë duke pasur parasysh që në institucionin tonë dorëzohet gjithë dokumentacioni që vjen nga organet mbështetëse, nga ILDKPI-ja, DSIK-ja, KLD-ja dhe Prokuroria e Përgjithshme. Këto janë raporte vlerësimi nga organizmat mbështetëse të parashikuara nga ligji në mënyrë periodike të herëpashershme. Në këto kushte, një specialist protokollit ka këtë ngarkesë ekstra.

Nga ana tjetër, kemi edhe dokumentacion sekret, i cili duhet të trajtohet në mënyrë të veçantë si gjithë protokollit tjetër. Te ne bëhet edhe procedura e arkivimit të dosjes në përfundim të tyre.

Në këto kushte, një specialist protokollit, që gjithashtu shoqëron edhe dosjen kur apelohej pranë Kolegjit të Apelit, është e pamundur të ndjekë gjithë gamën e gjerë të punës që ka. Kjo është arsyeja pse kam kërkuar edhe dy specialistë shtesë për protokoll-arkivën.

Kemi kërkuar gjithashtu një shtesë prej dy specialistësh për sekretarinë gjyqësore. Faktikisht, ne jemi të organizuar në katër trupa gjyqësore dhe që në fillim kemi marrë 4 specialistë që nga struktura e parë, por për shkak të punës kuptojmë që është e pamundur që një specialiste gjyqësore të arrijë të organizojë punën me dosje nga fillimi në fund deri në dorëzimin e saj në Apel për 9 dosjet që ka në çdo hedhje shorti për trupën që mbulon, tre komisionerë me nga tri dosje. Ndaj kemi kërkuar këtë shtesë specialistësh.

Nga ana tjetër kemi kërkuar gjithashtu edhe një specialist prokurimesh për shkak të fluksit të madh të punës që kanë të gjithë pjesëtarët e stafit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. E kuptoj dhe e di që mund të ngrihen njësi prokurimi të përkohshme apo të përhershme me punonjësit, por do t'i pengonte në mbarëvajtjen e procesit të rivlerësimit.

Kërkesa e fundit që kemi bërë në këtë shtesë strukture ka qenë edhe një punonjës pastrimi, pasi godina jonë është tri katëshe, që administrohet nga ana jonë për një staf aktualisht prej 50 vetash, por që presupozohet të rritet në 65 vetë dhe një punonjëse e vetme e ka të pamundur të përballojë kushtet e higjienës kur aty ndodhet edhe salla e seancave, që do të jetë e mbushur nga media dhe përfaqësues të publikut, apo familjarë të subjektit.

Ndërkohë, përveç shtesës së strukturës, kolegja ime Valbona, do t'ju sqarojë për kërkesën që kemi bërë lidhur me ndryshimin e kategorisë së pagës së disa prej punonjësve tanë.

**Ulsi Manja** – Fjala për zëvendësministren e Financave.

*(Diskutime pak mikrofon)*

Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, unë i kam në axhendë, për marrëveshjen. Dakord!

Departamenti i Administratës Publike, a ka përfaqësues?

Zini vend, ju lutem!

Ata e kanë konfirmuar pjesëmarrjen e tyre për marrëveshjen, por nuk kam konfirmimin e pjesëmarrjes për strukturat. Meqenëse jeni prezentë, mund të vazhdoni, sa më shkurt ju lutem, sepse zoti Fino, është shumë i qartë karshi kërkesave që ju keni paraqitur.

**Valbona Sanxhaktari** – Unë do jua përmbledh sa më shkurt fjalën time. Struktura dhe organika e pagave e të tria institucioneve të vetingut miratohet me vendim të Kuvendit, pasi është e njëjta. Duke qenë se të gjitha pagat e personelit për institucionet tona u referohen kategorive në vendimin e Këshillit të Ministrave për pagat, punonjësi i IT-së, pastrueset apo magazinierët në të gjithë administratën shtetërore përfitojnë shtesa, përkatësisht 2 mijë apo 7 mijë lekë të reja. Këto shtesa nuk i përfitojnë punonjësit tanë, sepse sipas Departamentit të Administratës Publike ne kemi rregullim të posaçëm, prandaj duhet që në vendimin e Kuvendit, kur të rregullohen pagat tona me referencë, të shkruhet, jam duke iu referuar personelit, jo komisionerëve, i përfitojmë këto shtesa ashtu siç i përfitojnë të gjithë punonjësit e tjerë në administratën shtetërore.

Ne kërkojmë që ky rregullim në vendimin e Kuvendit që ka miratuar strukturën tonë të pasqyrohet me qëllim që të gjithë të përfitojnë atë që ju takon dhe që duhet t’i kishin që prej fillimit.

Ndoshta përfaqësuesit e departamentit mund ta shpjegojnë më mirë këtë gjë.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Vazhdojmë me zonjën Laerta Poda, sekretare e Përgjithshme e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

**Laerta Poda** – Përshëndetje!

Në fillim doja t’ju kërkoja ndjesë që zonja Natasha nuk mundi të ishte sot prezente në takim, për shkak të pjesëmarrjes në një proces gjyqësor, i cili është duke u zhvilluar aktualisht në kolegji.

Unë jam këtu për t’ju përcjellë kërkesat, diskutimet, vendimmarrjet dhe gjithë mbështetjen që Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka për sa i takon strukturës organike për mbështetjen e procesit që po zhvillohet aktualisht.

Siç jeni në dijeni, ne kemi parashtruar dy kërkesa në Komisionin e Ligjeve. Kërkesa e parë dhe më e rëndësishmja ka të bëjë me shtimin në strukturë të numrit të punonjësve.

Kërkesa e dytë, ashtu siç u trajtua edhe nga institucioni tjetër, e përfaqësuar nga zonja Genta, ka të bëjë me kërkesën për riklasifikim të pagave që ne kemi kërkuar për disa pozicione pune të lidhura me administratën gjyqësore.

Në mënyrë të shkurtër do të ndalem te kërkesa, pasi ne ju kemi sjellë një material, i cili përmban analizën dhe parashtrimet që ne kemi bërë. Ju bëj me dije që Kolegji i Posaçëm i Apelit ka bërë një studim të plotë të strukturës dhe ka vlerësuar në tërësinë e saj se kjo strukturë ka nevojë për një shtesë prej 15 punonjësish, të cilën e ka ndarë në dy vjet.

Është vlerësuar një shtesë prej 10 punonjësish si e domosdoshme dhe emergjente për vitin 2018 dhe 5 punonjës i ka parashikuar për vitin 2019. Kjo kërkesë është bërë pjesë edhe e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021, i cili është paraqitur edhe në Komisionin e Ligjeve, sipas detyrimit që ne kemi përcaktuar te ligji nr. 84/2016.

Aktualisht, Kolegji i Posaçëm i Apelit e ka përfunduar komplet procesin e rekrutimit të stafit, ka miratuar kuadrin e brendshëm ligjor të domosdoshëm për funksionimin e institucionit dhe mbështetjen e aktivitetit të tij dhe në analizën e ngarkesës së punës së deritanishme, por edhe të asaj që parashikohet në vijim, duke pasur parasysh ecurinë e procesit edhe në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, është vlerësuar si e domosdoshme nevoja për një shtesë prej 10 punonjësish për vitin 2018.

Konkretisht, sa i takon pjesës së ecurisë së procesit, do të doja t'ju bëja me dije faktin se vetëm për muajin shtator është vënë re një rritje e numrit të ankimeve të paraqitura në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, kundrejt gjithë periudhës 8-mujore, ku deri në muajin gusht janë regjistruar 12 çështje, 10 prej të cilave i takojnë juridiksionit të rivlerësimit dhe 2 juridiksionit disiplinor. Vetëm në dy javët e para të muajit shtator janë depozituar pranë Kolegjit 7 ankime të tjera që i takojnë juridiksionit të rivlerësimit. Pjesa më e madhe e shtesës së strukturës lidhet me mbështetjen e procesit të rivlerësimit, konkretisht ajo që është edhe kërkesa më e madhe lidhet me këshilltarët ekonomikë.

Kolegji i Posaçëm i Apelit ka paraqitur kërkesën për 4 këshilltarë ekonomikë.

Ashtu siç vihet re deri, tani pjesa më e madhe e ankimeve, të cilat janë paraqitur në Kolegji lidhen me komponentin e vlerësimit të pasurisë që e kërkon dhe e bën të domosdoshme praninë në proces gjyqësor të këshilltarit ekonomik, i cili do të përgatisë relacionin, materialin shpjegues

dhe orientues për t'u trajtuar pastaj nga gjyqtarët në proces. Aktualisht çdo këshilltar ekonomik ka për momentin 4 çështje paralel për t'i shqyrtuar dhe trajtuar deri në paraqitjen e tyre për diskutim.

Kolegji i Posaçëm i Apelit ka në strukturë 7 këshilltarë ligjorë dhe 3 këshilltarë ekonomikë. Në propozimin tonë është kërkuar që ky numër të shkojë 7 këshilltarë ligjorë dhe 7 ekonomikë. Pra, çdo gjyqtar të ketë në dispozicion të tij një trupë të përberë nga 2 këshilltarë ligjorë dhe ekonomikë.

Kërkesa e dytë ka të bëjë me përkthyesin. Ashtu siç tha edhe zonja Genta gjuha e komunikimit dhe zyrtare e të dy institucioneve është gjuha shqipe dhe gjuha angleze. Përkthyesit deri tani janë përballuar me një volum pune, i cili ka të bëjë me përkthimin e relacioneve të përgatitura nga këshilltarët ligjorë dhe ekonomikë për t'u trajtuar nga vëzhguesit e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. Përveç kësaj, është e nevojshme të bëhet përkthimi i çdo vendimi, i cili do të publikohet edhe në faqen zyrtare të institucionit. Dua t'i mëshoj faktit që institucioni, përveç gjuhës shqipe, faqen zyrtare të tij e ka edhe në gjuhën angleze.

**Ulsi Manja**- Zonja Poda, ju lutem, fokusohuni te kërkesat, sepse argumentimin e plotë të gjithë sa keni kërkuar e kemi të qartë dhe e kemi mbi tavolinë. E kam edhe për efekt të opinionit publik, pasi njerëzit e kuptojnë më mirë kur thoni që doni 8 këshilltarë ekonomikë, 2 përkthyes e të tjera, sepse njerëzit janë më të qartë kur kanë kërkesa strikte.

**Laerta Poda**- Kërkesa jonë është për 10 këshilltarë ekonomikë, 2 përkthyes, 1 specialist IT-je, 1 specialist prokurimi, punëtor mirëmbajtjeje dhe punonjës pastrimi. Kjo ka qenë kërkesa jonë e parashtruar për vitin 2018. Nëse është nevojshme që të parashtrroj argumentet për postet, jam e gatshme.

**Ulsi Manja**– Zoti Ballhysa, keni fjalën, si përfaqësues i institucionit të Komisionerëve Publikë.

**Florian Ballhysa** – Faleminderit!

Ne vijmë në Kuvend pas një viti nga momenti që është miratuar vendimi nr. 94/2017 për strukturën dhe klasifikimin e pagave të punonjësve të institucionit të Komisionerëve Publikë. Mund të themi se kemi bërë më të mirën e mundshme me atë numër punonjësish që na është miratuar në vitin 2017 nga Kuvendi i Shqipërisë që të arrijmë të realizojmë kompetencat kushtetuese dhe ligjore për të cilat ky institucion funksionon në procesin e vlerësimit.

Mund t'ju them se sot të tri institucionet konfirmojnë se procesi i vetingut po funksionon dhe ka hyrë në rrugën e parashikuar në Kushtetutë dhe në ligj, pra po punojmë me kapacitete të



plota. Vetëm gjatë muajve maj, korrik dhe gusht pranë komisionerëve publikë kanë ardhur për t'u shqyrtuar 40 vendime të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe me një statistikë rreth 10 vendime të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë duke u shqyrtuar ose janë shqyrtuar nga institucioni ynë.

Ndryshe nga dy institucionet e tjera, institucioni i Komisionerëve Publikë ka një afat për shqyrtimin dhe vendimmarrjen e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit prej 15 ditësh, çka është një ngarkesë shtesë sidomos për t'u përballuar nga këshilltarët tanë ligjorë dhe ekonomikë.

Kjo është arsyeja kryesore pse ne kemi ardhur në këtë komision për të kërkuar një shtesë në numrin e këshilltarëve, pra të njësisë ligjore të këtij institucioni, nga 6 që është miratuar në vitin 2017, për të kaluar në numrin 10, pra një shtesë prej 4 këshilltarësh, 2 juridikë dhe 2 ekonomikë. Është kërkuar një shtesë, siç u argumentua edhe nga kolegët, për një specialist jurist në strukturën e administratës së institucionit për efekt të procedurave konkurruese. Në kërkesën tonë ne kemi argumentuar edhe një funksion shtesë që duhet të ketë ky specialist, që është studimi i praktikave më të mira, pra si një specialist që do të ishte mbështetës i njësisë ligjore, por jo në atë kategorizim pagash që kanë këshilltarët e njësisë ligjore.

Kemi kërkuar dhe riklasifikimin e pagave në të njëjtën logjikë me dy institucionet e tjera të specialistëve që i keni tashmë të miratuar në strukturë. Në mënyrë të përmbledhur kjo është kërkesa jonë të cilën e kemi konsultuar edhe me relatorin e çështjes.

**Ulsi Manja**- Faleminderit!

Fjalën e ka përfaqësuesi i Ministrisë së Financave.

**Elton Haxhi** - Ministria e Financave brenda fushës së përgjegjësisë së saj ka përlloritur kostot financiare për kërkesat e paraqitura nga institucionet e rivlerësimit. Në total kostoja financiare për 36 punonjës të shtuar ka një kosto vjetore 71 milionë lekë, ndërsa nga rivlerësimi i kategorizimit të pagave për 3 institucionet e rivlerësimit kostoja financiare shkon në 6,1 milionë lekë në vit. Në total fondi i nevojshëm për plotësimin e kërkesave të institucioneve të rivlerësimit kalimtar është rreth 80 milionë lekë në vit.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Po nga Departamenti i Administratës Publike?

**Enkela Dudushi** - Përshëndetje!

Lidhur me çështjen që ngriti Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për klasifikimi e pagave, më duhet të sqaroj për shkak edhe të kërkesës që ka bërë Kolegji i Posaçëm i Apelit në shkresën

e tij ku kërkon që institucioni të bëhet pjesë e vendimit të pagave të miratuara nga Këshilli i Ministrave, vendimit nr.187: Këshilli i Ministrave nuk mund të shprehet për pagat e këtyre 3 institucioneve. Pra, këto 3 institucione nuk mund të bëhen pjesë e vendimit nr.187 me vendim të Këshillit të Ministrave për shkak të përcaktimit që ka ligji specifik që thotë: “Klasifikimi i pagave është kompetencë e Kuvendit” Në rastin e këtyre 3 institucioneve, klasifikimi i pagave nuk do të thotë thjesht kategoria, ato që përcaktohen në strukturë: I-A, I-B, II-B janë kategori, nuk është klasifikim. Klasifikimi është që Kuvendi duhet të marrë vendim, ku referohen? Cilat klasa dhe cilët janë komponentët e klasave. Për këtë arsye kemi thënë se çdo gjë që ka të bëjë me pagat e këtyre 3 institucioneve duhet të përcaktohet në tekstin e vendimit të Kuvendit.

**Ulsi Manja**- Faleminderit!

Zoti Fino, si relator fjala është për ju.

**Bashkim Fino** – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj përfaqësuesit që janë prezentë! Ne kemi pasur disa takime bashkërisht për kërkesat. Kërkesat e tyre i kemi parë dyplanëshe: në kërkesat që kanë të bëjnë me qëllimin kryesor për të cilin janë ngritur institucionet, sepse janë institucione që i kemi krijuar vetë, të pavarura, janë komisione, të cilat i shërbejnë sistemit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe kanë për qëllim garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, si edhe rikthimin e besimit të publikut në të.

Nëse drejtuesit e këtyre institucioneve që janë këtu, që i falënderoj përsëri, e shprehën dhe thanë se para një viti ishin skeptikë, në kuptimin e asaj strukture që kaluam para një viti dhe të ngarkesës së punës, si edhe të ngarkesës së punës që do të kishin sot, ata janë më me këmbë në tokë në kuptimin që sot janë më në gjendje të bëjnë një vlerësim të ngarkesës së punës së tyre. Ky vlerësim që bëhet sot, shqyrt që bëhet para projektbuxhetit të vitit 2019 është një hap pozitiv, të cilin e kemi parë me kujdes, e kemi trajtuar me kujdes me këto institucione. Kjo do të thotë se për pjesën kryesore për të cilën kanë kërkuar, që i shërbejnë punës, qëllimit kryesor për të cilat janë ngritur si institucione, unë në relatimin tim, që e keni përpara mbi tavolinë, ju kam shprehur mundësinë që t’i mbështesim 100% pa asnjë hezitim, sepse nëse kërkohen këshilltarë ekonomikë, siç tha kryetarja e Komisionit të Pavarur, këshilltarët juridikë janë aty, 8 juristë, 4 këshilltarë ekonomikë, një këshilltar ekonomik duhet t’i përgjigjet punës voluminoze të trajtimit të dosjeve që kanë për çdo subjekt dhe që duhet të jetë një këshilltar ekonomik të mbulojë një jurist. Unë mendoj se është e domosdoshme kjo gjë, është e domosdoshme t’i miratojmë. Diskutimi që kemi

bërë në përgjithësi është se jemi munduar të bisedojmë për disa gjëra që mund të jenë të tepërta. Besoj se kemi arritur në një konsensus të plotë në miratimin e strukturës si strukturë, por edhe të klasifikimit, ashtu siç tha edhe përfaqësuesja e DAP-it këtu, e kemi në dorë, Kuvendi të drejtën për të marrë vendimin, ta shprehim në vendimin tonë. Nuk është çështje e vendimit të KM nr. 187, por është çështje e vendimit tonë si Kuvendi i Shqipërisë.

Zoti kryetar, duke folur dhe në emër të tyre, duke filluar me radhë, në sensin që kemi rakorduar me klasifikimin e pagave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka kërkuar 8 këshilltarë ekonomikë. Në ia miratojmë 8 këshilltarët ekonomikë, ka kërkuar 2 sekretari gjyqësore, edhe këto të dyja mendoj t'ia japim, ka kërkuar 2 përkthyes, edhe ata t'i kalojmë, ka kërkuar 2 punonjës të protokoll/arkivit. Në bisedimet që kemi bërë me kryetaren, e thamë se edhe 1 është i mjaftueshëm, por i shtojmë 1. Shtojmë edhe 1 punonjëse pastrimi, sepse është një godinë trekatëshe dhe për një pastrues nuk ia vlen të diskutojmë kaq gjatë. Në total Komisioni i Pavarur të Kualifikimit nga 16 punonjës që ka kërkuar, sipas relacionit që kam këtu miratojmë 14 të tillë, 8 këshilltarë ekonomikë, 2 sekretarë gjyqësorë, 1 një punonjës protokollit, 2 përkthyes dhe një punonjëse pastrimi.

Në përgjithësi të gjitha institucionet kanë kërkuar punonjës për prokurimet, unë si ekonomist e kam thënë se është e panevojshme të shtojmë thjesht një punonjës vetëm për prokurimet, kur kanë shumë pak prokurime për të bërë, nuk janë institucione definitive, janë me një afat kohor 5 vjet apo më gjatë, derisa të mbarojë klasifikimi, si të thuash i kualifikimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Mendoj se drejtoria Ekonomike dhe shërbimet mbështetëse që kanë 3 institucionet janë në gjendje t'u japin zgjidhje institucioneve për sa i përket punonjësit të prokurimeve. Pra, përfundimisht mendoj që Komisionit të Pavarur të Kualifikimit t'i miratojmë 14 punonjës nga këto shtesa që bëjmë. Ndërkohë të miratojmë sipas asaj që thashë më lart, por edhe nga përfaqësuesit e DAP-it që specialistët e sekretarisë gjyqësore nga IV-A të bëhet III-B. Kur të dalë vendimi, do ta shënojmë III-B. Specialistët për zbardhjen e redaktimit të vendimeve nga IV-B të bëhet në IV-A, specialist për pritjen e popullit nga IV-B në IV-A, specialist i protokollit/arkivit nga IV-B në IV-A.

Në fund, të gjithë institucionet kanë kërkuar që shoferi të kryejë dy funksione: shofer dhe korrier, sepse në fund të fundit ata janë në lëvizje të dosjeve dhe këtu duhet të shtojmë shofer/korrier nga 5 në 6 si klasifikim.

Propozimi që bëri zonja për shtesat e punonjësve të IT-së apo punonjësit e pastrimit duhet të përfitojnë edhe ata shtesat. Jam dakord, ta bëjmë një gjë të tillë kur të formulojmë vendimi, ta trajtojmë dhe këtë në vendimin përfundimtar. Besoj se i realizojmë pothuajse 95% të gjithë kërkesave të këtij institucioni, duke i hequr vetëm 1 specialist protokolli, ndërkohë që i shtuam 1, dhe 1 specialist të arkivit. Kjo për sa i përket kualifikimit të pagave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Për sa i përket Komisionit të Posaçëm të Apelit, mendoj të shtojmë 4 këshilltarë ekonomikë, siç kanë kërkuar, nga 4 të bëhen 7, ashtu siç kanë edhe 7 këshilltarë juridikë, specialistë të sekretarisë gjyqësore nga IV-A të bëhet III-B, specialist për zbardhjen e relatiemeve të vendimeve nga IV-B të bëhet në IV-A, të shtohet edhe një përkthyes, në fakt, kanë kërkuar 2, por ne 1 e pamë të nevojshme të shtojmë, specialist për pritjen e popullit nga IV-B në IV-A, shtojmë një specialist për IT-në, sepse sipas argumentit që dhanë këtu, ne kemi zhvilluar dy herë diskutime, është institucioni që i duhet më shumë se çdo institucion tjetër, nesër mund t'i duhet edhe Komisionit të Pavarur, por tani për tani për Komisionin e Posaçëm të Apelit mendoj se është i domosdoshëm një punonjës i IT-së. Specialist për protokollin/arkivin nga IV-B bëhet në IV-A dhe shofer/korrier nga 5 në 6. Pra, gjithsej i shtojmë 6 punonjës nga 10 që ka kërkuar, nga 37 do të shkojë në 43 punonjës, ndërsa komisioni i mëparshëm nga 50, do të shkojë në 64 punonjës që do të pasqyrohen në vendimin përkatës. Ndërkohë që si për Komisionin e Pavarur edhe për Komisionin e Apelit të gjithë shtesa e punonjësve të IT-së do të jetë njëjloj për të 3 institucionet, që të mos e përmend disa herë. Besoj se kemi rënë dakord me ta, jemi në një linjë.

Kalojmë te komisionerët publikë, kanë një kërkesë modeste, kërkojnë shtimin e këshilltarëve, 2 juristë dhe 2 ekonomistë, nga 4 juristë të shtohen edhe 2, nga 2 këshilltarë ekonomikë të shtohen 2. Gjithsej do të jenë 6 këshilltarë juridikë dhe 4 këshilltarë ekonomikë. Edhe këta kanë kërkuar një punonjës për prokurimet, por mendoj se nuk është e nevojshme, sepse kanë drejtorinë Ekonomike të Shërbimit. Te komisionerët publikë, nëse të dyja institucionet e tjera ka sekretar të Përgjithshëm, te Komisioni për Prokurimin Publik ka kancelar, sepse kështu e ka edhe vendimi për gjykatat, në mos. Ideja është se kancelari, sipas vlerësimit që merret në gjykatë, duhet të ketë pagë jo I-B, por I-A, dhe unë mendoj ta ketë I-A. Ndërkohë, specialist sekretarie, nga 4-A në 3-B, specialistë redaktorë gjyqësorë nga 4-B në 4-A. Specialistë për pritjen e popullit, si të gjithë, nga 4-B në 4-A; specialistë arkivi, nga 4-B në 4-A. Në fund, shoferë, korrierë, nga 5 në 6.

Pra, nga pesë kërkesat që kanë bërë komisionerëve publikë, ne miratojmë katër. Pra, nga 26 punonjës që ka sot, do të shtohen dhe do të bëhen 30 punonjës.

I thashë në mënyrë të detajuar të gjitha këto shifra, edhe për sa i përket tabelës së klasifikimit të pagës dhe strukturës, sepse kur të nxjerrim vendimin, do ta nxjerrim të plotë. Sepse, zoti kryetar, na takon neve si Kuvend, që ta nxjerrim një vendim të tillë, domethënë klasifikimin e pagës, numrin e punonjësve, gjë për të cilët gjej rastin të them se qeveria është përgjigjur pozitivisht, ngaqë ka mundësi financiare. Unë kam bërë një konsultë me ta edhe para fillimit të kësaj seance. U kam thënë: ju keni mundësi financiare sot, për shkak të vendeve vakante që keni pasur, e që mbase nuk i keni ezauruar akoma. Më thanë se kanë mundësi financiare brenda këtij viti, që do të thotë se propozimi im, i cili do të jetë edhe në projektvendim, është se këto tre projektvendime që ne do të kalojmë sot, duhet t'i kalojmë urgjentisht në parlament, me qëllim që të hyjnë në fuqi menjëherë.

E them këtë “menjëherë”, sepse kemi dy tablo: e para, për një muaj vjen projektbuxheti për vitin 2019, e natyrisht duhet të planifikohen për buxhetin e 2019-ës. E dyta, më kryesorja, është se në momentin kur ne të hapim dritën jeshile me vendimin e menjëhershëm të këshilltarëve e të punonjësve, këta duhet të hapin procedurat e konkurrimit, që kërkon nga ju një afat kohor të caktuar prej njëzet ditësh apo një muaji. Vendimi ynë, nëse e marrim këtë të enjte apo të enjten tjetër, duhet të jetë sa më i shpejtë, që në mes të tetorit apo në fund të tetorit të jetë efektiv. Fondin e pagave e kanë, që të fillojnë qysh këtë vit me numrin e ri të punonjësve.

Shpresoj se vlerësimi që ata i kanë bërë punës së tyre në lidhje me ngarkesën që kanë, të jetë pozitiv. Gjithsesi, ne këtu jemi, dhe mbase do të shihemi prapë vitin tjetër, pavarësisht se mund të shihemi edhe pas një muaji për projekt-buxhetin e 2019-ës, për të zgjidhur gjithë problematikën që ata kanë në lidhje me çështjen dhe qëllimin kryesor për të cilin janë ngritur. Ne duam t'i ndihmojnë, që ata të vazhdojnë me shpejtësi e me hapa gjigantë, sepse edhe vetë e kuptojnë se, që nga dita kur janë krijuar e deri tani kur mbushet viti, është një numër i vogël i çështjeve që kanë gjykuar. Besoj se me ritmin që do të kenë, të nxitur prej këtij vendimi, do të kenë më shumë mundësi të bëjnë vlerësime të prokurorëve e të gjyqtarëve.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Lidhur me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, zonja Bungo, dakord me ato që sugjeron relatori?

**Genta Bungo** – Dakord!

**Ulsi Manja** – Dakord! Atëherë e hedhim në votim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Struktura janë këto. Nuk ka pengesa për pyetje, por këto struktura janë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Gjithsesi, ju mund ta bëni pyetjen, zoti Hyseni.

**Alket Hyseni** – Zoti kryetar, duke qenë se janë të pakta rastet kur këto struktura paraqiten para Komisionit të Ligjeve, dhe duke qenë se është një proces shumë i rëndësishëm, nëpërmjet këtij rasti dëshiroj të shtroj një pyetje. Mund të jenë disa, por në thelb një është.

Shoh se ka një kërkesë masive nga të tre institucionet, për të kanalizuar kërkesat për burime njerëzore në këshilltarë e në ekonomi. Unë po paraqes opinionin tim, që gjykoj se nuk është vetëm imi, por edhe i një sërë kolegëve, edhe i një pjese të opinionit publik, të paktën duke pasur parasysh ata me të cilët ne kontaktojmë. A mos këto institucione kanë harruar se kanë tre komponentë vlerësimi në punën e tyre, që është komponenti profesional, por edhe pastërtia e figurës, dhe janë futur në një proces teknik të verifikimit pasuror, duke e shndërruar procesin thjesht në një strukturë të re të verifikimit të pasurisë. Pra, kemi ILDKPI-në, dhe tashti po dalim me një strukturë të re. Pra, mendoj se po u çalon procesi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ka lidhje me strukturën, zoti Fino, pavarësisht se jam dakord me çfarë rehatuat ju.

Mendoj se këtij procesi po i ikën sharmi. Qytetarët shqiptarë nuk kanë pritur vetëm që të nxjerrim nga radhët një gjyqtar apo një prokuror, të cilëve mund t'u mungojnë disa qindra mijë lekë në justifikimin e tyre, në kushtet kur dihet e ekonomia jonë ka qenë informale. Jam i bindur se edhe vetë anëtarët e komisionit mund të kenë vështirësi për të justifikuar me dokumentacion legal disa qindra mijë lekë apo disa milionë lekë.

Prandaj jam i shqetësuar, se fokusi duhet të jetë edhe te elementi profesional. Mund të jenë shumë të rralla rastet kur është diskutuar lidhur me paaftësinë profesionale të trupës së gjyqtarëve e të prokurorëve. Unë mendoj se ky është një aspekt shumë i rëndësishëm. Ka mes tyre gjyqtarë e prokurorë të paaftë profesionalisht, gjë që duhet të diskutohet, ndërkohë, shumica e procedimeve po mbyllet me një komponent: me komponentin pasuror.

Prandaj dhe në kërkesat që vijnë, ju kërkoni mundësisht nga një këshilltar ekonomik për kokë, që ju, relator, me bujarinë tuaj ia dhatë. Unë e kuptoj se duhet t'ua japim politikisht, për të

mos pasur konteste, që të thonë se nuk ua dhamë. Për çdo kërkesë tuajën, unë jam pro. Ju keni një proces pune shumë të vështirë, shumë delikat, por duhet ta bëni ashtu sikundër janë kërkesat kushtetuese dhe ligjore. Jo t'i bini shkurt: një komponent, e pastaj hap krahun dhe ec!

Unë mendoj se, nëse Kolegji i Apelit do të bjerë ndesh me KPK-në, do të kemi problematikë të madhe. Prandaj duhet të shkojë i argumentuar në tre komponentë. Si ka mundësi që nuk shqyrtohen problematikat, kur një gjyqtari i janë kthyer ose i janë prishur pothuajse mbi pesëdhjetë për qind të çështjeve të tij nga Apeli dhe Gjykata e Lartë. Për mua kjo do të ishte e mjaftueshme për ta nxjerrë nga radhët, sepse është i paaftë personalisht. Nuk ka fare rëndësi pastaj, nëse ai nuk justifikon dot 700 mijë lekë të pasurisë së tij, për shembull. Pra, të mos e katandisim gjithë këtë proces, sepse shqiptarët e dinë mirë si ka qenë ekonomia para njëzet e pesë apo më shumë vite. Shqiptarët mund ta justifikojnë moralisht një gjyqtar, nëse nuk gjen faturat për disa të ardhura, por nëse ju u thoni qytetarëve shqiptarës e ky gjyqtar ka gabuar mbi pesëdhjetë për qind të vendimeve të tij, shqiptarët e kuptojnë se ai duhet të ikë patjetër nga sistemi.

Këtë shqetësim kisha, zoti kryetar! Unë besoj se edhe komisioni që do të konfigurujë së shpejti parlamenti, prej të cilit katër anëtarë u ngritën, por do të vijë edhe i pesti, do të ketë mundësi që, shumë shqetësime të opinionit publik, të Kuvendit, të vetë trupës që punon çdo ditë, t'i bëjë publike, t'i bëjë prezente, dhe pse jo, t'u japë zgjidhje. Meqenëse i kishim këtu tre përfaqësuesit, shfrytëzova rastin të shprehja shqetësimin tim, i cili besoj se nuk është vetëm imi.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Hyseni!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, një sekondë, zoti Fino!

Në fakt, zoti Hyseni, tani në fund ju e thatë se Kuvendi dhe Komisioni i Ligjeve ka instrumente, të cilat ia ka dhënë Kushtetuta e ligji, dhe këtë informacion duhet ta marrim nëpërmjet Komisionit të Pavarur të Monitorimit, që shumë shpejt do të fillojë nga puna. Sot jemi mbledhur për strukturat e këtyre tre institucioneve. Vendimi që do të marrim pak më vonë në lidhje me kërkesat që kanë bërë të tre institucionet e vetingut, është detyrë e këtij komisioni, ndërsa shqetësimet që ju ngritët, në gjykimin dhe vlerësimin tim janë tërësisht çështje të vendimmarrjes së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, që janë institucione të pavarura kushtetuese dhe sovrane në marrjen e vendimeve. Gjithsesi, ne kemi

mekanizmat për marrjen e informacionit të duhur, por nuk besoj se kjo është pjesë e kësaj mbledhjeje.

Zoti Fino, ju lutem edhe një fjalë të fundit, përpara se ta hedhim në votim projektvendimin.

**Bashkim Fino** – Fjala ime e fundit është se, natyrisht, vlerësimi nuk ka të bëjë me thelbin se si janë krijuar institucionet, se vlerësimi për gjyqtarët e prokurorët bëhen mbi baza profesionale dhe ekonomike.

Në strukturën që kemi miratuar para një viti, zoti kryetar, unë shikoj, edhe për shkak të pozicionit që kam si ekonomist, se numri i këshilltarëve ekonomikë është shumë i vogël. Numri i dosjeve të veprimeve ekonomike, siç tha edhe kolegu ime, është shumë i madh. Në qoftë se gjyqtarët janë të prirë të marrin vendim, por presin që të japë miratimin këshilltari ekonomik, në lidhje me çështje të cilat janë kontrolluar, për një gjyqtar apo një prokuror, të paktën siç e kuptoj unë, numri i këshilltarëve është shumë i vogël, kështu që shkaktohen vonesa në vendimmarrjen e këtyre institucioneve.

Ajo që ne po bëjmë sot nuk është politike, përkundrazi. Unë jam politik këtu, por gjithsesi jam relator, dhe nga pikëpamja teknike. Jam marrë shumë herë me buxhetet dhe me strukturat. Është vlerësimi që ne duhet të ecim paralelisht, si pjesa juridike, ashtu edhe pjesa ekonomike.

Unë nuk mund të them dot, i takon këtyre të flasim me vendimet që bëjnë se si dënohet një gjyqtar apo një prokuror, dënohet thjesht për çështje ekonomike apo dënohet për vendimmarrjen e tij profesionale e të tjera më radhë. Këto janë çështje të tyre, janë çështje edhe të atij komisionit që ne kaluam para një jave në parlament, komisioni që do të ngrihet këtu me qëllim që të monitorojë tre institucione dhe do të na japë neve informacion si Komision Ligjesh dhe si parlament dhe pastaj ne kemi të drejtë të kërkojmë llogari.

Në rastin konkret ne miratojmë një strukturë, numrin e punonjësve, tabelë pagash dhe rrisim kapacitetin ekonomik, sepse është më i vogël, dhe kur u vu në fillim u duk sikur duheshin më shumë juristë se ekonomistë, por na ndodh që duhet të ecim paralelisht të dyja, edhe pjesa juridike, edhe pjesa ekonomike.

Më lejoni t'ju them se një këshilltar sot punon me 50 dosje ekonomike dhe nuk mund të punojë dot një këshilltar me tri trupa gjykuese, pra një këshilltar ekonomik sot punon me tri trupa gjykuese juristësh. Çfarë po bëjmë ne në rastin konkret? Ne po themi se do t'i shtojmë këshilltarët ekonomikë, me qëllim që çdo trupë të ketë këshilltarin e vet ekonomik dhe numri i dosjeve që ka një këshilltar ekonomik të ulet paksa për ta bërë edhe kontrollin më të mirë, sepse në qoftë se unë



jam ekonomist dhe kam për detyrë të kontrolloj 50 dosje, të jeni të bindur që nuk është njësoj sikur të jemi tre ekonomistë këtu dhe t'i ndajmë 50 dosjet me qëllim që kontrolli të jetë më efektiv dhe më i mirë. Ky është thelbi i projektvendimit.

Kolegu im ngriti një çështje tjetër që, le të themi, s'ka të bëjë me projektvendimin që ne paraqesim, prandaj unë mendoj se në qoftë se të gjithë jemi dakord, ne sugjerimit i kemi bërë, prandaj t'i kalojmë pa hezitim.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Atëherë hedhim në votim projektvendimin “Për një shtesë personeli në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, sipas propozimit të relatorit, kolegut Fino, dhe të dakordësuar me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, edhe me sugjerimin për hyrjen në fuqi menjëherë të këtij projektvendimi.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet projektvendimi sipas propozimeve të bëra nga relatori, kolegu Fino, për t'i kaluar seancës plenare për votim.

Hedhim në votim projektvendimin “Për disa ndryshime të strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të posaçëm të apelimit”.

Kush është dakord, sipas propozimit të kolegut Fino, edhe me hyrjen në fuqi menjëherë?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Hedhim në votim projektvendimin “Për një shtesë të numrit të punonjësve dhe riklasifikim të pagave të administratës së institucionit të komisioneve publikë”, me propozimet e kolegut Fino.

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Falënderoj kolegun Fino për punën serioze që ka bërë për këto projektvendime të tre institucioneve të pavarura të vetingut!

Falënderoj përfaqësuesit e këtyre institucioneve, zonjën Bungo, zotin Ballhysa, zotin Sina, zonjën Poda dhe zonjën Sanxhaktari!

I uroj një ditë të mbarë, punë të mbarë!

Kam edhe një sugjerim miqësor. Duke qenë se Kuvendi po e bën detyrën e vet si duhet, duke propozuar edhe hyrjen në fuqi menjëherë të këtij projektvendimi, ky sugjerim miqësor është për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, që sa më shpejt të jetë e mundur, brenda afateve të përcaktuara

në Kushtetutë dhe në ligj të shprehet në lidhje me vendimmarrjen, në lidhje me ankimet e bëra, qoftë nga subjektet e rivlerësimit, por edhe nga komisioneri publik, sepse kështu do t'i hapet rrugë sa më shpejt konstituimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Gjithsesi, absolutisht, ne do të jemi vazhdimisht në mbështetje të tre institucioneve. Shumë shpejt do të vijë edhe buxheti. Ne i kemi marrë edhe kërkesat e të tre institucioneve lidhur me projektbuxhetin e vitit 2019 dhe të jeni të sigurt se do të gjeni mbështetjen e Komisionit të Ligjeve, të Kuvendit të Shqipërisë, por edhe të qeverisë, gjithmonë në funksion të punës suaj delikate, por edhe serioze që ju ka ngarkuar Kushtetuta dhe ligji.

Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 25 shtator 2018, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt Am Main, për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV””

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina dhe Tom Doshi.

#### **Mungojnë:**

Oerd Bylykbashi, Enkelejd Alibeaj, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka.

Elton Haxhi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Vilma Causholli - shefe Sektorit të Politikave të Pagave në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Brikena Jazxhi - specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

**Ulsi Manja** – Vazhdojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt Am Main, për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV””.

Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relatore është kolegja Elena Xhina. Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë kanë konfirmuar pjesëmarrjen zoti Elton Haxhi, zëvendësministër, zonja Vilma Çausholli, shefe Sektori e Politikave të Pagave në Drejtorinë e Përgjithshme Buxhetit dhe zonja Brikena Jazxhi, specialiste. Zoti Haxhi, ju lutem, bëni një prezantim të shkurtër të kësaj projekt marrëveshje për kolegët e komisionit, por edhe për opinionin publik. Pastaj fjalën e ka kolegja Xhina. Fjala për ju!

**Elton Haxhi** - Faleminderit!

Ndryshimi i marrëveshjes që ne propozojmë ka lidhje me një shtyrje në afatin e saj. Afati aktual i marrëveshjes është deri në qershor të vitit 2017 dhe kërkohet shtyrja deri më 30 tetor 2018. Arsyeja e kësaj shtyrje është vonesa në fillimin e aplikimit të kësaj marrëveshjeje. Jemi para faktit që për të përfunduar këtë marrëveshje duhet disbursuar edhe një vlerë përfundimtare, prej 5%, e cila ka lidhje me garancinë e punimeve, dhe me këtë pagesë përfundon aplikimi i kësaj marrëveshjeje. Prandaj kërkohet shtyrjen e afatit deri më 30 tetor, në mënyrë që të bëhet e mundur edhe disbursimi i kësaj shume përfundimtare.

**Ulsi Manja** - Faleminderit, zoti zëvendësministër! Zonja Xhina, fjala për ju!

**Elena Xhina**- Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit përfaqësuesve të ministrisë për praninë dhe për sqarimin që ata na dhanë. Ky projektligj vjen në këtë komision sipas kalendarit të parashikuar. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi dhe ky projektligj shqyrtohet në bazë të neneve 32 dhe 33 të Rregullores së Kuvendit.

Siç u deklarua edhe nga pala tjetër, qëllimi i këtij projektligji dhe ardhja e kësaj marrëveshje huaje është ndryshimi i afatit të disbursimit të fondeve, që kërkohet të jetë 30 tetori 2018, si dhe zëvendësimi i emërimit nga Ministria e Financave në Ministri e Financave dhe Ekonomisë kudo në tekstin e kësaj marrëveshjeje huaje.

Si përfundim, në aspektin ligjor, vlerësohet se ky projektligj i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi dhe në aspektin procedural është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Si relatore vlerësoj rëndësinë e miratimit të këtij projektligji dhe propozoj që edhe kolegët ta miratojnë në komision. Faleminderit!

**Ulsi Manja** –Faleminderit, zonja Xhina!

A ka pyetje dhe diskutime nga kolegët? Nuk ka.

Atëherë, hedhim në votim në parim projektligjin. Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale”.

E hedhim në votim nen për nen projektligjin.

Neni 1. Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Hedhim në votim në tërësi projektligjin.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga ministria e Financave, Fondit Shqiptar i Zhvillimit dhe KfW Frankfurt për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale”.

Ky projektligj së bashku me raportin e komisionit tonë do t'i përcillet komisionit përgjegjës, më pas seancës plenare për votim.

Këtu mbyllim diskutimin pikën e katërt të rendit të ditës.

Faleminderit dhe ditë të mbarë, zoti Zëvendësministër!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 25.09.2018, ora 12:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja - kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Seancë dëgjimore me kandidatët për një vend vakant në Bordin e Institutit për Studimet e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri.

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina dhe Tom Doshi.

#### **Mungojnë:**

Oerd Bylykbashi, Enkelejd Alibeaj, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka.

#### **Të ftuar:**

Alfred Lako – kandidat për një vend vakant në Bordin e Institutit për Studimet e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri

Peter Saraçi – kandidat për një vend vakant në Bordin e Institutit për Studimet e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri

Bajram Gjishiti – kandidat për një vend vakant në Bordin e Institutit për Studimet e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri

**Ulsi Manja** – Kalojmë te pika e pestë e rendit të ditës, seancë dëgjimore me kandidatët për një vend vakant në Bordin e Institutit për Studimet e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Të ftuar janë tre kandidatët: zoti Alfred Lako, zoti Peter Saraçi dhe zoti Bajram Gjishti.

Sipas rendit alfabetik vazhdojmë seancën dëgjimore me kandidatin e parë në radhë, me zotën Alfred Lako.

Ju lutem, një shpjegim për kolegët e mi të komisionit. Kjo vakancë e krijuar në Bordin e Institutit për Studimet e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri është krijuar në datën 24.05.2018, për shkak se njëri nga anëtarët e këtij bordi ka ndërruar jetë, për rrjedhojë mandati i tij ka përfunduar në kushtet e shkronjës “e”, pika 1 të nenit 9 të ligjit nr. 1242, datë 25.02.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”. Pra, jemi në kushtet e vdekjes së njërit prej anëtarëve të këtij Bordi, të profesorit të nderuar, zotit Kolec Topalli, ndjesë pastë, i cili për disa vjet ka qenë anëtar shumë i nderuar i Bordit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.

Janë njoftuar për në orën 12:30. Nëse kandidatë nuk janë paraqitur, do të bëjmë 10 minuta pushim, për të rifilluar më 12:30.

Kjo është një seancë dëgjimore me kandidatët për një vend vakant në Bordin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relatore do të jetë kolegja Vasilika Hysi.

Kandidatët që kanë dorëzuar dokumentacionin pranë Kuvendit të Shqipërisë janë zoti Alfred Lako, zoti Petër Saraçi dhe zoti Bajram Gjishti.

Sot në këtë seancë dëgjimore është paraqitur kandidati Alfred Lako. Zoti Lako është kandidat për në Bordin e Institutit. Sipas dokumentacionit që ka paraqitur pranë Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura, plotëson kushtet dhe kriteret për të qenë një nga kandidatët në këtë bord. Ligji dhe procedura përcaktojnë një seancë dëgjimore me Komisionin e Ligjeve. Ndaj, do t’ju lutem, zoti Lako, një prezantim të shkurtër, pasi dokumentet tuaja janë në tryezën e Komisionit të Ligjeve dhe secili nga kolegët e mi deputetë i ka parë, lidhur me aktivitetin tuaj në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, përpos *background*-it tuaj si inxhinier, në mos gaboju.

Fjala është për ju.

**Alfred Lako** – Përshëndetje! Quhem Alfred Lako dhe jam 56 vjeç. Aktualisht, jam pedagog pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit në Departamentin e Mjedisit. Jam arsimuar në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe në shkollën e lartë të Inxhinierisë Informatike në Francë.

Aktualisht, jam pedagog pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe kam një aktivitet të gjerë jashtë Fakultetit si projektues dhe konsulent në fushën e mjedisit.

Lidhur me kandidimin tim, aplikoj për këtë post sepse tashmë kam eksperiencë si pjesëtar i Bordit të këtij Instituti prej dy mandatesh, si dhe një eksperiencë të mirë në njohjen e ligjeve lidhur me aktivitetin e këtij Bordi. Njëkohësisht, kam edhe një arsye personale. Duke qenë se vij nga një familje që ka prejardhje të persekutuarish, dëshiroj të aderoj si anëtar i këtij Bordi.

**Ulsi Manja** – Zona Bushka, keni fjalën.

**Klotilda Bushka** – Në fakt, zoti Alfred Lakoi i plotëson të gjitha kriteret që parashikon ligji për të kandiduar për këtë vakancë të krijuar në Bordin e Institutit. Ka një CV shumë të pasur dhe, pavarësisht prejardhjes dhe lidhjes me familje, të cilat janë goditur nga sistemi komunist, unë shikoj që CV-ja juaj është e pasur si për sa i takon aspektit akademik, ashtu edhe atij profesional (ju përgëzoj për këtë), çka tregon edhe mbijetesën e njerëzve të mençur dhe të pamundur për të ecur në jetë pavarësisht sfidave që hasin. Unë nuk kam ndonjë pyetje për kandidatin, por rekomandoj që t’i kaloj seancës plenare për votim. Nëse kolegët kanë ndonjë pyetje, janë të lirë ta bëjnë.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Bushka!

Ndonjë nga kolegët ka pyetje për zotin Lako? Nuk ka.

Zoti Lako, faleminderit për prezencën në Komisionin e Ligjeve dhe ditë të mbarë!

**Alfred Lako** – Ditë të mirë edhe juve!

**Ulsi Manja** – Kandidati Peter Saraçi është paraqitur?

**Artur Baku** – Zoti kryetar, kandidati është njoftuar, dje ka konfirmuar pjesëmarrjen, por sot ka lajmëruar që për arsye objektive nuk mund të paraqitet.

**Ulsi Manja** – Kandidati, ...?

**Artur Baku** – Nuk është paraqitur dhe nuk ka dorëzuar asnjëlloj dokumentacioni.

**Ulsi Manja** – Po zonja Zamira Çavo?

**Artur Baku** – Zonja Zamira Çavo është përjashtuar një herë nga ky komision, sepse nuk përmbush kriteret ligjore.



Shërbimet e Kuvendit, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, i kanë kërkuar subjektit propozues depozitim të një kandidature tjetër alternative. Kandidatura tjetër alternative është ajo e zotit Bajram Gjishti, por zoti Gjishti nuk ka paraqitur asnjë dokumenti.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Baku!

Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Kam diçka për kandidatin Peter Saraçi, për të cilin ju thatë që nuk është paraqitur për arsye objektive. Ai mund të mos ketë pasur mundësi të vinte për momentin, jo se nuk do që të vijë. Meqenëse kriteret janë dhe ne si komision e kemi CV-në, mund ta trajtojmë si kandidat ose mund ta thërrasim një herë tjetër.

**Ulsi Manja** – Praktika parlamentare njeh edhe raste që, edhe pse nuk është paraqitur në seancë dëgjimore, kandidati i është dërguar seancës plenare në rastet kur ka plotësuar kushtet dhe kriteret. Gjithsesi, të shprehet relatorja për sa i përket rastit të zotit Peter Saraçit. Çmohet e nevojshme seancë dëgjimore me zotin Peter Saraçi apo është e mjaftueshme për komisionin që t'ia dërgojë seancës si kandidaturë alternative, së bashku me atë të zotit Lako, duke qenë se plotëson kushtet dhe kriteret?

**Klotilda Bushka** – Zoti Peter Saraçi i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret ligjore. Të gjitha të dhënat për CV-në e tij, duke filluar që nga formimi akademik e më tej me ushtrimin e profesionit, janë të qarta nga dokumentacioni që ka paraqitur. Çështja e seancës dëgjimore është në çmimin tonë. Nëse ne mjaftohemi me informacionin që na është vënë në dispozicion për të njohur kandidatin dhe duke qenë se zoti Saraçi ka një arsye objektive për mospjesëmarrjen sot, mund ta konsiderojmë të ezauruar këtë fazë. Nëse kolegët kanë nevojë që të njihen me kandidatin duke i bërë pyetje drejtpërdrejtë, kjo është një çështje që edhe mund të merret në konsideratë dhe të shtyhet. Unë gjykoj që informacionet janë të mjaftueshme, por le të vendosë komisioni për procedimin. Nëse ne dërgojmë dy kandidatë në seancë plenare, jemi në rregull me kriteret ligjore dhe nuk kemi asnjë pengesë.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Bushka!

Zoti Baku, ju lutem, a ka qenë zoti Saraçi në këtë komision në seancë dëgjimore?

**Artur Baku** - Zoti Saraçi para 6 muajve ka qenë një nga kandidatët dhe komisioni e ka vlerësuar se i përmbush kriteret ligjore pikërisht për këtë pozicion që konkurren sot.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Baku!

Të nderuar kolegë, jeni dakord që t'ia kalojmë seancës plenare edhe kandidaturën e zotit Saraçi së bashku me kandidaturën e zotit Lako?

Pas kësaj seance dëgjimore me kandidatin Lako, komisioni e pa të arsyeshme, konform ligjit dhe Rregullores së Kuvendit, që edhe kandidati tjetër Peter Saraçi, duke qenë se plotëson kushtet dhe kriteret e kërkuara nga ligji për të qenë në garë për anëtar të Bordit të Institutit për Studimet e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri, zë bashku me zotin Lako dhe raportin përkatës t'i kalojnë seancës së plenare për votim.

Këtu e mbyllim mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Faleminderit dhe ditë të mbarë! Mbledhja e radhës do t'ju njoftohet nga sekretaria e komisionit.

## **MBYLLET MBLEDHJA**

